



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 51, datë 11.02.2020

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ANALIZIMIN E AFTËSIVE  
PROFESIONALE TË PROKURORIT  
ERVIN KARANXHA

Bazuar në nenet 149/a, 179/b, nenin “E” (aneksi) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 189, pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenet 40 dhe 42 të Ligjit Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 71 dhe 94 të Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me raportin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokurorit **Ervin Karanxha**, sipas draftit bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij raporti i dërgohet menjëherë Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR  
BESNIK CANI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
VATË STAKA

